



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 849
Datë: 14/4/2023

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur më 13.4.2023, mori vendim të shpallë:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve të doktoratës për vitin akademik 2022/23

I. Kushtet e përgjithshme

1. Bursa universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve të doktoratës. Shuma vjetore e bursës do të jetë: 800 euro.
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët të cilët i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës;
 - 2.2. Të jenë studentë të pranuar në vitet akademike 2021/22 dhe 2022/23;
 - 2.3. T'i kenë të regjistruar të dy semestrat e vitit akademik 2022/23.

II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika I e këtij konkursi, aplikimin duhet ta bëjnë përmes platformës elektronike SEMS në linkun: studenti.uni-pr.edu
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
 - 2.1. Kërkesa për aplikim (Fletë aplikacioni), e cila shkarkohet pas aplikimit online përmes SEMS.
3. Studenti obligohet që Fletë aplikacionin ta printoj dhe ta dorëzoj në shërbimin e studentëve të fakultetit përkatës, si dëshmi që ka aplikuar brenda afatit të paraparë të konkursit.
4. Fakultetet janë të obliguara që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs t'i përgatisin listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për fitimin e bursës universitare për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.
5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave do ta bartin dekanët e njësive akademike.
6. Nëse gjatë aplikimit paraqiten probleme eventuale teknike, të kontaktohet zyrtari i TI-së në njësinë akademike përkatëse.

III. Afati i aplikimit

1. Aplikimi në linkun studenti.uni-pr.edu hapet prej datës 14.4.2023 deri me datë 28.4.2023, në orën 16:00.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë 14.4.2023, aplikimi elektronik do të funksionalizohet nga ora 13:00.

IV. Afati i ankesave

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej dyzet e tetë (48) orësh pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në zyrën e arkivit të UP-së (nr. 18), në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.
3. Ankesat e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve dhe ueb faqet e fakulteteve, si dhe në ueb faqen e Universitetit: www.uni-pr.edu.

